

PITAGORA KONSTRUKSION sh.p.k

2012

Pasqyrat financiare vjetore

per periudhen nga

1 Janar 2012 deri me 31 Dhjetor 2012

PERMBAJTJA

RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR	3
PASQYRAT FINANCIARE	
BILANCI KONTABEL	4
BILANCI KONTABEL (VAZHDIM)	5
PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	6
PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE	7
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL	8
SHENIME TE PASQYRAVE FINANCIARE	9-19



AUDIT & ACCOUNTING

Adresa Rr. Ismail Qemali
Pall. 34/1 Ap. 2/1
Tirane, Albania

Phone: (+355 4) 2278 028
Fax: (+355 4) 2278 028
Email: irena.pulo@ild-99.com

RAPORT I AUDITORIT TE PAVARUR

Drejtuar :Ortakve te shoqerise
“ Pitagora Konstruktion ” sh.p.k

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare Individuale te “ **Pitagora Konstruktion** ” sh.p.k qe përfshijnë bilancin individual më 31 Dhjetor 2012, pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve,pasqyren e ndryshimeve ne kapitalin e vet dhe pasqyren e flukseve te parave per vitin e mbyllur ne kete date si dhe një permbledhje të politikave kontabël kryesore dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrime apo pasaktësira; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme per rrethanat.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë gabime materiale.

Auditimi përfshin procedura për të marrë prova auditimi për vlerat dhe paraqitjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë dhe vlerësimin e riskut të egzistencës së gabimeve materiale në pasqyrat financiare, qofshin rezultat i mashtrimeve apo pasaktësira. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, auditori konsideron kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektetiviteten e kontrollit të brendshëm të entitetit. Nje auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërine e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit të auditimit.

Opinionit


Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare Individuale paraqesin ne menyre te sinqerte ne te gjitha aspektet materiale gjendjen financiare te “ **Pitagora Konstruktion** ” sh.p.k me 31.12.2012 te rezultatit financiar dhe te flukseve te saj te parave ne fund te vitit te mbyllur ne kete date ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

Ekspert Kontabël i Regjistruar

“ I.L.D. – 99 Audit ” sh.p.k.

Irena HOXHA (PULO)

Rruga “ Ismail Qemali ” pall 34/1 Ap 2/1 Tirane



Tiranë, më 03 Mars 2013

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
Me 31 Dhjetor 2012**

	AKTIVET	Shenime	31.12.2012	31.12.2011
Mjetet Monetare	4		50,061,020	27,447,790
Banka			49,472,835	26,785,221
Arka			588,185	662,569
Derivate dhe Aktive Financiare te mbajtur per tregtim				
Derivatet			-	-
Aktivet e mbajtur per tregtim			-	-
Totali			50,061,020	27,447,790
Aktive te tjera Financiare afatshkurter				
Llogari kerkesa te arketueshme	5		455,511,633	429,274,307
Llogari kerkesa te tjera te arketueshme			7,376,701	7,626,742
Totali			462,888,334	436,901,049
Inventari				
Lendet e para	6		2,553,573	152,380
Prodhimi ne proces			-	-
Produkte te gatshme			-	-
Mallra per rishitje			-	-
Totali			2,553,573	152,380
Aktive Biologjike afatshkurter				
Aktive Afatshkurtra te mbajtur per shitje			-	-
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	7		44,559,012	47,042,076
Total i Aktiveve Afatshkurtra			560,061,939	511,543,295
Aktive Afatgjata				
Aktive Afatgjata Materiale				
Toka			-	-
Ndertesa dhe Instalime te pergjithshme			-	-
Makineri dhe pajisje (neto)	8		491,191	570,697
Aktive te tjera afatgjata materiale (neto)			80,227	39,222
Totali			571,418	609,919
Aktive Biologjike Afatgjate				
Kapitali aksionari i papaguar			-	-
Aktive te tjera afatgjata (ne proces)			-	-
Totali i Aktiveve Afatgjata				
TOTALI I AKTIVEVE			571,418	609,919
			560,633,357	512,153,214

Administratori
M. Krasniqi
M

Hartuar nga



[Signature]
[Signature]

Pasqyrat financiare vjetore per periudhen
nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2012

Pasqyra e Pozicionit Financiar
Me 31 Dhjetor 2012 (Vazhdim)

	<i>Shenime</i>	31.12.2012	31.12.2011
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrimet Afatshkurta			
Derivatet		-	-
Huamarrjet		-	-
Huate afatshkurtra		-	-
Kthimet/Ripagimet e huave afatgjata		-	-
Bono te konvertueshme		-	-
Totali		-	-
Huate dhe parapagimet			
Te pagueshme ndaj furnitoreve	9	15,520,685	10,701,735
Te pagueshme ndaj punonjesve	10	905,929	199,887
Detyrimet tatimore	11	278,078	22,700
Hua te tjera		-	-
Parapagimet e arketueshme		-	-
Totali		16,704,692	10,924,322
Grantet dhe te ardhura te shtyra		-	-
Provizionet afatshkurtra		-	-
Totali Detyrime Afatshkurtra		16,704,692	10,924,322
Detyrimet Afatgjata			
Huate afatgjata		-	-
Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare		-	-
Bonot e konvertueshme		-	-
Totali		-	-
Huamarrje te tjera afatgjata	12	525,881,620	484,778,839
Provizionet afatgjata		-	-
Grandet dhe te ardhura te shtyra		-	-
Totali Detyrime Afatgjata		525,881,620	484,778,839
Totali i Detyrimeve		542,586,312	495,703,161
Kapitali			
Akisonet e pakices		-	-
Kapitali i aksionereve te shoqerise meme		-	-
Kapitali i aksionar	13	100,000	100,000
Primi i aksionit		-	-
Njesite ose aksionet e thesarit		-	-
Rezerva statutore		-	-
Rezerva ligjore		-	-
Rezerva te tjera		-	-
Fitimi i pashperndare		16,350,054	16,224,389
Fitimi (humbje) e vitit financiar	14	1,596,992	125,665
Totali i Kapitalit		18,047,045	16,450,054
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		560,633,357	512,153,215

**Pasqyra e te Ardhurave e Shpenzimeve
Me 31 Dhjetor 2012**

Te ardhura e shpenzime	Shenime	31.12.2012	31.12.2011
Te Ardhurat			-
Shitjet neto			-
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	15	21,666,377	2,169,244
Ndryshimet në inventarin e produktevetë gatshme dhe prodhimit në proces			-
Materialet e konsumuara	16	8,874,272	1,806,377
Kosto e punës			
-pagat e personelit	17	8,133,000	-
-shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore		1,087,555	-
-shpenzime per honorare		-	-
Amortizimet dhe zhvlerësimet	18	125,648	-
Shpenzime të tjera	19	1,658,752	202,979
Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)		19,879,227	2,009,356
Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore(1+2+/-3-8)		1,787,150	159,888
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara		-	-
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		-	-
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare		-	-
Të ardhurat dhe shpenzimet te tjera financiare		-	-
Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat	20	2,925	6,630
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	21	(15,640)	(16,814)
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare		-	-
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare(12.1+/-12.2+/-12.3+/-12.4)		(12,715)	(10,184)
Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)		1,774,435	149,705
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	22	177,443	24,040
Tatim Fitimi i Shtyre		-	-
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar(14-15)		1,596,992	125,665

Pasqyra e Fluksit Monetar
Me 31 Dhjetor 2012

Pasqyra e fluksit monetar-Metoda indirekte		Viti 2012	Viti 2011
I	Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit	ne LEK	ne LEK
	Fitimi para tatimit	1,596,992	149,705
	Rregullime per:		
	Amortizimin	125,648	-
	Humbje nga kembimet valutore	-	-
	Te ardhura nga investimet	-	-
	Shpenzime per interesa	-	-
	(Rritje) / renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti		
	(Rritje) / renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme te tjera	(23,504,221)	(11,051,106)
	(Rritje) / renie ne tepricen e inventarit	(2,401,193)	233,673
	Rritje / (renie) ne tepricen e detyrimeve, per tu paguar nga aktiviteti dhe te tje	46,883,151	9,662,530
	(Rritje) / Renie ne shpenzimet e shtyra		
	Interesi i paguar	-	-
	Tatim mbi fitimin i paguar	-	(24,040)
	MM neto nga aktivitetet e shfrytezimit	22,700,377	(1,029,238)
II	Fluksi monetar nga veprimtarite investuese		
	Blerja e shoqerise se kontrolluar X minus parate e arketuara	-	-
	Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(87,147)	-
	Te ardhura nga shitja e paisjeve	-	-
	Interesi i arketuar	-	-
	Dividentet e arketuar	-	-
	MM neto e perdorur ne aktivitetet investuese	(87,147)	-
III	Fluksi monetar nga veprimtarite financiare		
	Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner	-	-
	Te ardhura nga huamarrje afatgjata	-	-
	Pagesat e detyrimeve te qirase financiare	-	-
	Dividentet e paguar	-	-
	MM neto e perdorur ne aktivitetet financiare	-	-
	Rritja / renia neto e mjeteve monetare	22,613,230	(1,029,237)
	Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel	27,447,789	28,477,026
	Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel	50,061,020	27,447,789



[Handwritten signature in blue ink]

*Pasqyrat financiare vjetore per periudhen
nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2012*

Pasqyra e Levizjeve te Kapitalit
Me 31 Dhjetor 2012

Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapital

	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Rezerva te tjera	Fitimi i pashpërndarë	Fitimi i Ushtrimit	Totali
Pozicioni më 01.01.2010	100,000	-	-	15,788,222	436,167	16,324,389
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël						-
Transferuar ne humbje te akumuluar				436,167	(436,167)	-
Emetimi i kapitalit aksionar						-
Pozicioni më 31.01.2010	100,000	-	-	16,224,389	-	16,324,389
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël						-
Fitimi neto për periudhën kontabël					125,665	125,665
Transferuar ne humbje te akumuluar						-
Emetimi i kapitalit aksionar						-
Pozicioni më 31.12.2011	100,000	-	-	16,224,389	125,665	16,450,054
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël						-
Fitimi neto për periudhën kontabël					1,596,991	1,596,991
Dividendët e paguar				125,665	(125,665)	-
Emetimi i kapitalit aksionar						-
Pozicioni më 31.12.2012	100,000	-	-	16,350,054	1,596,991	18,047,045



*Pasqyrat financiare vjetore per periudhen
nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2012*

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

1. Informacion i pergjithshem per Shoqerine

Shoqeria "Pitagora Konstruktion" sh.p.k eshte rregjistruar ne Rregjistrin e Shoqerive me vendimin e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane nr.35,631 date 04.05.2006. Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte veprimtari ne fushen e ndertimeve. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000.

Shoqeria "Pitagora Konstruktion" sh.p.k gjate vitit ushtrimor 2012 ka ushtruar aktivitet te kufizuar ne fushen e ndertimit te nje pallati ku po vete shoqeria eshte edhe investitore.

Shoqeria eshte e rregjistruar prane deges se Tatim Taksave Tirane dhe ka paguar rregullisht detyrimet tatimore.

2. Parimet e pergatitjes se pasqyrave financiare

2.1 Bazat e pergatitjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK).

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne Lek, e cila eshte dhe monedha funksionale e Shoqerise.

2.4 Vleresime dhe gjykime

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te shoqerise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje ne varesi te ketyre vleresimeve.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel jane te njohura ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar si dhe ne periudhat e ardhshme qe preken.



Ne vecanti, informacion mbi fushat me te rendesishme te vleresimeve dhe gjykimeve ne aplikimin e politikave kontabel te cilat kanë efektet me te rendesishme ne shumat e njohura ne pasqyrat financiare, jane pershkruar ne shenimet perkatese te pasqyrave financiare. Përdorimi i vleresimeve kontabel eshte minimal ne keto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtesine e veprimeve te realizuara nga Shoqeria.

3. POLITIKA KONTABEL

Politikat kontabel te meposhtme jane aplikuar ne menyre konsistente ne te gjitha periudhat te paraqitura ne pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare ne monedhe te



Pasqyrat financiare vjetore per periudhen
nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2012

huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

	31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2011
1 EUR	139.59	138.93
1USD	105.85	107.54

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (Mjete monetare)

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

3.3 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Pasqyrat financiare vjetore per periudhen
nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2012

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshire koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale

3.4 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

3.5 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

i. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



Pasqyrat financiare vjetore per periudhen
nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2012

ii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

iii. Amortizimi (vazhdim)

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin aktual është si më poshtë:

Aktive	Përqindja
Makineri dhe pajisje	20%
Mobilje dhe orëdi	20%
Pajisje zyrash dhe informatike	25%
Mjete Transporti	20%
Instalime të përgjithshme	5%

3.6 Zhvlerësimi

Aktivët financiarë

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3.7 Zhvlerësimi (vazhdim)

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me pare në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiarë të matur me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.8 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, kur Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.9 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.10 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet llogarisë fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.11 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.12 Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.



4. MJETE MONETARE

Shoqëria ka llogari bankare në leke dhe në valute. Për gjendjet në valute është bërë rivlerësimi me kursin fikse të Bankës së Shqipërisë në dt. 31.12.2012 dhe diferencat janë pasqyruar në rezultatin e shoqërisë. Gjendja e likuiditeteve në bankë dhe në arke me 31.12.2012 paraqitet si më poshtë:

	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Vlera monetare në LEK		
Banka	49,472,835	26,785,211
Arka	588,185	662,569
Total	50,061,020	27,447,780

“Pitagora Konstruktion” sh.p.k operon me disa banka ku përmendim NBB Banke, Union banke, BIA ku ka llogari në Euro, dhe me BIA-në ku ka llogari edhe në leke dhe në usd. Gjate vitit ushtrimor shoqëria ka kryer transaksione me të gjitha bankat. Kontabilizimi i bankave është bërë rregullisht. Gjendjet e bankave në fund të vitit rakordon me shifrat e bilancit.

Në postin e likuiditeteve arka paraqitet me gjendjen 588,185 leke dhe perputhet me gjendjen e arkës të datës 31.12.2012. Dokumentacioni është në perputhje me ligjin për kontabilitetin.



Pasqyrat financiare vjetore për periudhën
nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2012

5. LLOGARI TE ARKETUESHME

Klientet dhe kërkesa të tjera të arketueshme detajohen si më poshtë:

	2012 ne LEK	2011 ne LEK
Klient	455,511,633	429,274,307
Te arktueshme të tjera	7,376,701	7,626,742
Total	462,888,334	436,901,049

Ne postin “*Kërkesa të arketueshme*”, Paraqitet vlera 455,511,633 leke dhe në këtë post shoqëria ka paraqitur shumën e situacioneve të punimeve për objektet që shoqëria po nderton në komunën Kashar Tiranë. Shuma e paraqitur në këtë post përputhet me vlerën e punimeve në celje shtuar me punimet e vitit 2012.

Punimet e ndërtimit gjatë vitit 2012 janë kryer nga vetë shoqëria.

“*Te arktueshme të tjera*” i barabartë me 7,376,701 leke përfaqëson shumën e tatimit fitimit të derdhur me tepër në organet tatimore deri në mbyllje të vitit 2012. Shuma e pasqyruar në bilanc përputhet me gjendjen në fillim të vitit, shtuar me derdhjet e vitit 2012 dhe zvogëluar me shumën e detyrimit për tatim fitimin 2012.

Gjithashtu këtu paraqiten edhe një shumë e sigurimeve shoqërore të derdhura tepër në organet tatimore për të cilën po rakordohet.

6. INVENTARI

	2012 ne LEK	2011 ne LEK
Lendet e para	2,553,573	152,380
Prodhim në proces		
Produkte të gatshme		
Mallra për rishitje		
Totali	2,553,573	152,380

Paraqitet në kontabilitet me shumën 2,553,573 leke në mbyllje të vitit ushtrimor nga 152,380 leke që ishte në celje. Gjendja përfaqëson lendet e para në magazine në 31.12.2012.

Në fund të vitit ushtrimor shoqëria ka kryer inventarin fizik të lendeve të para dhe shuma e inventarit përputhet me gjendjen në bilanc. Lendet e para në magazine ndiqen dhe evidentohen në llogarinë perkatese me metodën e “Inventarit të ndërmjetëm” dhe vlersohen me koston e marrjes së tyre.

*Pasqyrat financiare vjetore për periudhën
nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2012*

7. PARAPAGIMET DHE SHPENZIMET E SHTYRA

Me poshte jane paraqitur zerat qe perbejne kete grupim te cilat lidhen me shpenzime te shtyra te cilat i perkasin vitit 2012 si me poshte:

	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Parapagim dhe shpenzime te shtyra	44,559,012	47,042,076
Total	44,559,012	47,042,076

Ne postin “Shpenzime per tu shperndare” paraqitet shuma 44,559,012 leke e cila perfaqeson vleren e taksave per objektin qe po investon dhe nderton shoqeria. Gjithashtu ketu perfshihet edhe vlera e studimit sizmologjik dhe e projektit.

Shuma e mesiperme do ti shtohet koston se ndertimit ne momentin e shitjes.

8. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Aktive tjera afat gjata materiale	571,418	609,919
Total	571,418	609,919

Aktivet jane paraqitur ne bilanc ne vlere neto pra duke I zbritur amortizimin. Aktivet e qendrueshme te blera pasqyrohen ne bilanc me koston historike.

Aktivet e qendrueshme te trupezuara jane te evidentuara ne kontabilitet ne llogarite perkatese dhe te vleresuara me koston historike te korigjuara me amortizimin e akumuluar.

9. LLOGARI TE PAGUESHME

Ne kete ze jane paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitoreve. Me poshte jane paraqitur keto detyrime sipas monedhave:

	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Furnitore	15,520,685	10,701,735
Total	15,520,685	10,701,735

Ne postin “Furnitor per blerje dhe sherbime „ (9.1)

Paraqitet shuma 15,520,685 leke qe perfaqeson detyrimin e shoqerise ndaj disa furnitoreve per blerje te ndryshme materialesh ndertimi.

Detyrimet e mesiperme jane te konfirmuara dhe shumat e konfirmimit perputhen me kontabilitetin.



Pasqyrat financiare vjetore per periudhen
nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2012

10. DETYRIME NDAJ PUNONJESVE

	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Te pagueshme ndaj punonjesve	905,929	199,887
Total	905,929	199,887

Ne postin "Te pagueshme ndaj punonjesve"

Paraqitet shuma 905,929 leke qe perfaqeson detyrimet e shoqerise ndaj punonjesve per pagat e muajit Dhjetor 2012.

11. DETYRIME TATIMORE

	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Detyrime tatimore	278,078	22,700
Total	278,078	22,700

Ne postin Detyrime Tatimore = 278,078 leke

12. HUAMARRJE AFATGJATA

	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Huamarrje afatgjata	525,881,620	484,778,839
Total	525,881,620	484,778,839

Ne postin Huamarrje te tjera Afatgjata **525,881,620 leke**

Ne kete post jane perfshire fiancime te ortakeve si investitor per ndertimin e apartamenteve te banimit si edhe parapagime te klienteve per kontrata porosie. Shuma e paraqitur ne bilanc eshte e analizuar.

13. KAPITALI

Kapitali i nenshkruar


Kapitali themeltar i rregjistruar ne gjykate eshte me vlere 100.000 leke.

Fitime e humbje te mbartura

Pagyrohet me vleren 16,350,054 leke, qe perfaqeson fitimin e shoqerise te mbartur nga vitet e kaluara.

Fitime e humbje te ushtrimit

Fitimi neto i vitit ushtrimor pas llogaritjes se tatimit mbi fitimin eshte ne shumen 1,596,992 lek



Pasqyrat financiare vjetore per periudhen
nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2012

14. REZULTATI I PERIUDHES

	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Rezultati tatimor	Vlera ne leke	Vlera ne leke
Fitimi/(Humbja) para tatimit	1,774,435	149,705
Fitim/Humbje e mbartur		
Shpenzime te panjohura	-	90,695
Fitimi fiskal	1,774,435	240,400
Tatim fitimi (10 %)	177,444	24,040
Fitimi/(Humbja) Neto	1,596,992	125,665

15. TE ARDHURAT

Analiza e te ardhurave te Shoqerise eshte si me poshte:

	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Te ardhura nga shitja	-	-
Te ardhura te tjera	21,666,377	2,169,244
Total	21,666,377	2,169,244

Sic shihet, te ardhurat ne total per periudhen ushtrimore jane ne shumen 21,666,377 leke. Ne shumen e te ardhurave nga ndertimet perfshihen te ardhurat nga punimet e ndertimit te kryera per objektet qe shoqeria po nderton ne komunen Kashar Tirane. Shuma e paraqitur ne kete post perputhet me vleren e punimeve te situacioneve. Shuma e te ardhurave e pasqyruar ne bilanc perputhet me shumen e situacioneve te punimeve te kryera, shumen e shitjeve ,ajo perputhet me shumen e fdp ve. Te ardhurat e shoqerise jane te kontabilizuara sakte dhe ne mbeshtetje te dokumentave justifikuese.

16. KOSTO E LENDEVE TE PARA MATERIALE

	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Lende te para dhe materiale	8,874,272	1,806,377
Total	8,874,272	1,806,377

Peshen specifike me te madhe ne totalin e shpenzimeve e ze zeri " Materiale te para dhe materiale te tjera " te cilat perfaqesojne blerjet e vitit ushtrimor. Nga verifikimi rezultojne se ne kete ze jane permbledhur blerjet e vitit per materialet te perdorura per ndertimin. Pothuajse te gjitha shpenzimet e ketije zeri jane me fature tatimore me tvsh.



Pasqyrat financiare vjetore per periudhen
nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2012

17. SHPENZIMET E PERSONELIT

Ne keto shpenzime te paraqitura ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve paraqiten zerat e shpenzimeve si me poshte:

	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Pagat e personelit	8,133,000	-
Sigurime shoqerore	1,087,555	-
Total	9,220,555	-

18. SHPENZIME AMORTIZIMI

Shpenzimet e amortizimit gjate vitit 2012 paraqiten si me poshte :

	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Shpenzime amortizimi	125,648	-
Total	125,648	-

19. SHPENZIME TE TJERA

	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Shpenzime te tjera	1,658,752	202,979
Total	1,658,752	202,979

Eshte zeri ne te cilin pasqyrohet shuma 1,658,752 leke. Ne kete ze perfshihen shpenzimet per sherbime te ndryshme komisione bankare, shpenzime te qerase se zyrove, shpenzime telefoni energje si dhe shpenzime te ndryshme.

20. TE ARDHURA DHE SHPENZIME NGA INTERESAT

Te ardhurat e realizuara nga interesat gjate vitit ushtrimor 2012 paraqiten si me poshte :

	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Të ardhurat nga interesat	2,925	6,630
Total	2,925	6,630

*Pasqyrat financiare vjetore per periudhen
nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2012*

21. FITIM (HUMBJE) NGA KURSI I KEMBIMIT

Fitim/humbja e shoqerise nga kembimet ne valute te huaj paraqitet si me poshte :

	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Fitimet nga kursi i këmbimi	-	-
(Humbjet) nga kursi i këmbin	(15,640)	(16,814)
Total	(15,640)	(16,814)

22. SHPENZIME TATIM FITIMI

Shpenzimet e Tatim fitimit per vitin 2012 paraqiten si me poshte:


	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Shpenzime tatim fitimi	177,443	24,040
Total	177,443	24,040

23. TRANSAKSIONE ME PALET E LIDHURA

Gjate vitit ushtrimor 2012 kompania nuk paraqet transaksione me palet e lidhura.

24. NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT

Nuk ka asnje ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.



Pasqyrat financiare vjetore per periudhen
nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2012